



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 10.03.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit dhe projektit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, “Marrësi”, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Fondi Shqiptar për Zhvillim, “Agjencia Zbatuese e projektit” dhe KfW Frankfurt mbi Main, “KfW”, për fondet IPA të Bashkimit Evropian për furnizimin me ujë të zonave rurale III”.
2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit dhe projektit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, “Marrësi”, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Fondi Shqiptar për Zhvillim, “Agjencia Zbatuese e projektit” dhe KfW Frankfurt mbi Main, “KfW”, për masat shoqëruese për furnizimin me ujë të zonave rurale III”.
3. Projektligji “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (nenet 135- 160)

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Blendi Klosi, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Petrit Vasili, Silva Caka, Eduart Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka.

Mungojnë: Tom Doshi

Të ftuar:

Leonard Miloti - përgjegjës i Njesisë së Projekteve Hidroteknike, në Fondin Shqiptar të Zhvillimit.

Ermir Omari - kordinator për projektin e KfW-së në Fondin Shqiptar të Zhvillimit.

Eljona Bylykbashi, specialiste në Ministrinë e Drejtësisë.

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëdita!

Sipas rendit të ditës, pikë e parë është projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit dhe projektit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, “Marrësi”, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Fondi Shqiptar për Zhvillim, “Agjencia Zbatuese e projektit” dhe KfW Frankfurt mbi Main, “KfW”, për fondet IPA të Bashkimit Evropian për furnizimin me ujë të zonave rurale III”.

Kush do të flasë nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit?

Urdhëroni, prezantohuni!

Leonard Miloti – Përshëndetje, jam përgjegjës i Njesisë së Ujësjetësve rural pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Ermir Omari - Specialist në Fondin Shqiptar të Zhvillimit në departamentin e Infrastrukturës.

Fatmir Xhafaj – Po, për procedurë.

Eduard Halimi – Meqenëse ju zoti kryetar jeni marrë pak personalisht dhe me mua pas krahëve, pasi jam larguar dhe është e disata herë që e bën (nuk e kam me ty, Dashi), dua të them dy fjalë.

Të them ty, por edhe atyre që na dëgjojnë nëpërmjet medieve, e para, këshilli për legjislacionin, meqë e ngrite si shqetësim dhe mezi pret që ai të mblidhet, do të mblidhet. Do të mblidhet brenda afateve që përcakton ligji, Rregullorja dhe Kushtetuta e Republikës.

Asnjë afat që përcakton ligji, Rregullorja dhe Kushtetua nuk do të shkelet, por ju mos i provokoni as qytetarët dhe as opozitën duke thënë: “Meqenëse ne kemi votat, ejani këtu po ua mbajti, se ua rrëzojmë për dy minuta”. Po ju them edhe një herë: Mos provokoni as opozitën dhe as qytetarët me kërkesën e ligjshme që ata kanë për largimin e Kryetarit të Kuvendit nga detyra.

Së dyti, para një jave nënkryetari i këtij komisioni, ju ka kërkuar që të mbani një qëndrim si kryetar i këtij komisioni, për dy deputetë të Kuvendit, ndaj të cilëve është porositur

t'u vihet tritol për të larë hesapet politike. Nuk të është kërkuar asgjë tjetër, veçse të mbash një qëndrim.

Një javë më përpara nga Partia Socialiste është përjashtuar nga grupi deputeti Tomë Doshi. Që të jem i sinqertë, as mua dhe as kolegëve të mi të opozitës nuk na bëhet vonë fare se kë përjashtoni ju nga grupi juaj i Partisë Socialiste, aq më shumë për zotin Tomë Doshi, të cilin ne e kemi pasur dhe kemi kundërshtarin tonë më të fortë politik nga viti 2005, kur ai ka hyrë në parlament. Dhe ju këtë gjë e dini. Ajo që ti dhe kryetari yt u fshehët qytetarëve shqiptarë ishte arsyeja se pse e përjashtuat Tomën. U thatë qytetarëve shqiptarë dhe neve, të gjithëve, se e përjashtuat Tomën se kishte sharë Briseidën. Se po të shante Toma Briseidën, e tha edhe në një emision televiziv, -“Ka thyer kodin”, po të shajë Briseidën unë e përjashtoj nga grupi. Madje tha “Çdo deputet përfshirë të gjithëve që jeni këtu, po e shatë Briseidën, do të përjashtoheni nga grupi”.

Sikur Toma të mos kishte folur publikisht, propaganda juaj do ta kishte bërë të besonin të gjithë se arsyeja e vetme e gjithë atyre që kishte ndodhur brenda këtyre 6 muajve na qenka Briseida. Por kur u bë publike, atëherë u detyruat ta mbyllnit një orë e më parë çështjen.

Arsyeja e vërtetë është tritoli. Tritoli i parapaguar për dy deputetët e Kuvendit. Ai tritol që erdhi nga lagjet më të largëta të Tiranës deri në këtë seli dhe në këto korridore. Katër ditë më parë tritoli plasi 200 metra larg shtëpisë tënde dhe larg shtëpisë sime. A e dëgjuan qytetarët, komshinjtë tanë, fqinjët tanë që dolën aty, pavarësisht se kujt i përkisnin, Partisë Socialiste apo asaj Demokratike? Ishin të gjithë të shqetësuar, sepse tritoli kërcënon të gjithë. Kërcënon jetën e fëmijëve, kërcënon sigurinë publike. Nuk ka gjë më të rëndësishme për çdo prind, për çdo fqinj, edhe atyre që u përplasen tritoli 4 ditë më parë 200 metra larg shtëpisë tënde dhe shtëpisë sime, te stadiumi “Dinamo”.

Gjëja më e rëndësishme që ka çdo qytetar shqiptar është siguria publike. Ndaj edhe ndonjëri mund të ndihet mirë kur me ndihmën e parave të krimit të organizuar vjen në pushtet; kur me ndihmën e parave të krimit të organizuar dhe narkotrafikut zë pasuri; kur me ndihmën e parave të narkotrafikut arrin të mbajë pushtetin, por ajo që është mbi të gjitha, përpara qytetarëve është siguria publike dhe ndalimi i krimit që të arrijë deri në parlament.

Ndaj kolegu Bylykbashi gjatë gjithë kësaj kohe ju ka kërkuar të mbani një qëndrim dhe të ndaleni ju dhe kryetari juaj në rrugën e arrogancës duke u treguar votat qytetarëve e duke u thënë: “Na dhatë votat, na duroni 4 vjet tani në kurriz...”

Fatmir Xhafaj – Zoti Halimi, ke ndonjë gjë për procedurë? Urdhëroni!

Përfundojeni se e zgjatët shumë!

Eduard Halimi – Ndaj ajo që të kemi kërkuar është të mbash një qëndrim si kryetar. Të mbash një qëndrim si kryetar i Komisionit të Ligjeve, sepse ne e kemi të qartë që ju nuk do të ndaleni, as ti nuk ndalesh në arrogancë, as kryetari yt dhe qeveria nuk do të ndalet. Ndaj kemi thirrur qytetarët më 12 mars. Ju vazhdoni me rendin e ditës. Ne e kemi me qytetarët! Përballuni me qytetarët dhe lëreni arrogancën! Rendi i ditës për ne është hallet dhe...

Fatmir Xhafaj – Atëherë, pse vini këtu kur nuk e keni këtë rend dite? Shpjegojuani qytetarëve!

Eduard Halimi – Po të kërkojmë të mbash një qëndrim mbi atë çka ka ndodhur.

Fatmir Xhafaj – Dil aty dhe...

Eduard Halimi – Jo, jo, të takon ty ta mbash qëndrimin si kryetar komisioni. Këtë po të kërkojmë!

Fatmir Xhafaj – Zotëri, unë të falënderoj shumë që ke kaq shumë besim te mua, sa qëndrimi im do të qetësojë shpirtin!

Eduard Halimi – E di pse? Jo, jo nuk më qetëson fare shpirtin. Nuk flas për ty, flas për qytetarët.

Fatmir Xhafaj – Po thuaju qytetarëve! Ti ma kërkon mua qëndrimin, nuk po ua kërkon atyre!

Eduard Halimi – Ne e kemi të qartë që ju nuk ndaleni, por do t’ju ndalojnë qytetarët. Ti e di shumë mirë që ata që tregohen arrogantë me qytetarët...

Fatmir Xhafaj – E pashë 8 vjet modelin e arrogancën.

Eduard Halimi – Kanë treguar këtu, kanë treguar edhe në vende të tjera si kanë përfunduar. Ndaj modelin e keni të qartë. Përballuni me qytetarët dhe lëreni arrogancën! Ne si rend dite kemi vetëm rendin me qytetarët!

Faleminderit!

(Opozita largohet nga mbledhja.)

Fatmir Xhafaj - Duhet të dëgjosh tani, sepse pastaj thua flet kur iki unë!

Rrini dhe dëgjoni!

Për procedurë, zoti Fino.

Bashkim Fino – Nuk kuptoj një gjë me ju, zoti kryetar, sepse jeni shumë tolerant dhe nuk e kuptoj vërtet këtë gjë. Këta të opozitës, me sa kam vënë re, vijnë dhe sa fillon mbledhja e komisionit, se vetëm Komisioni i Ligjeve ka punë përditë, siç duket, dhe e jep media përditë, thotë: “Për procedurë”, ndërkohë që ka filluar një projektligj shumë i rëndësishëm, bën deklaratën politike, të kundërvihet ty, si kryetar i komisionit, “Dhe unë, - thotë, - nuk kam punë me ty” Pasi kërkon përgjigje nga ty, - thotë, unë kam punë me qytetarët në datën 12 dhe ngrihet dhe ikën.

Ore zotërinj, thuajini atyre të opozitës, e kanë atë zyrën poshtë të shtypit, siç foli pardje zoti Mediu, në mos gaboj, dhe siç kanë folur gjithë të tjerët, të dalin atje dhe të mos na ndërpresin edhe ne punët të paktën, se fillojmë mbledhjen këtu dhe fillojmë me një procedurë që nuk ka lidhje me procedurën. Dhe më duket se toleranca tënde e ka lejuar këtë gjë, zoti kryetar. Mos lejo, se ai i mëparshmi nuk lejonte kështu! Nuk lejonte Eduardi të fliste në këtë mënyrë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Me thënë të drejtën, ju kërkoj të falur, se kur isha në korridor, pak më parë, dhe një gazetari i bëra një vërejtje dhe i thashë: “Ore, pse e keni thënë këtë? Se nuk është e vërtetë kjo që keni thënë këtu!”, u hodh një aty dhe tha – “Po ç’të bëj, tha, ai e tha atë se do të ushqejë kalamajtë”. Mirë, unë jam dakord, e kuptoj atë, se ai do të ushqejë kalamajtë, po këta, kë ushqejnë, more zotërinj? Se mirë, atij edhe i është dashur ta bëjë atë shkrimin se e kërkonte kryeredaktori, po ky, kë ushqen? Ushqen kryetarin e partisë? Po ai i ushqyer është. I duhet edhe ky lajm?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për procedurë, edhe juve, zoti Mediu?

Fatmir Mediu – Ma përmendi zoti Fino emrin, dhe jam anëtar i komisionit, qoftë dhe për procedurë.

Fatmir Xhafaj – Zoti Mediu, e keni një pro dhe një kundër.

Fatmir Mediu – E kam për procedurë, zoti Xhafaj!

Fatmir Xhafaj – Dakord, për procedurë!

Fatmir Mediu – Për procedurë dhe ju adresohem juve, si kryetar i komisionit.

Besoj se në autoritetin tuaj si kryetar i komisionit, do të ishte mirë që të ndërtoni një raport të drejtë me palët, pa interpretuar qëndrimet politike të palëve dhe pa fyer askënd, se kë ushqejnë dhe për çfarë ushqejnë deputetët e opozitës, besoj që e ka të qartë opinioni publik. Ne kemi qëndrim politik tonin, e thashë edhe dje, dhe po ju them edhe një gjë tjetër, zoti Xhafaj, se ne kemi një detyrë kushtetuese si Parlament, si deputet, por si Komision i Ligjeve dhe Kushtetutës në mënyrë të veçantë, kontrollin e zbatueshmërisë së ligjeve, kushtetutshmërisë nga ana e qeverisë, dhe qeveria shqiptare në këtë proces të denoncimit nga deputeti socialist ka shkelur Kodin e Procedurës Penale në më shumë se 4 nene.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Qeveria, Ministria e Brendshme dhe një pjesë e lartë e drejtuesve të qeverisë shqiptare.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dhe ne po e ngremë këtë çështje... Unë nuk thashë vetëm prokurorin, aspak! Ka një detyrë Parlamenti të kontrollojë zbatimin e ligjit nga qeveria.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, more, zoti Xhafaj, kontrollin punëtor dhe fshatar nuk e kam njohur unë. Ka mundësi tani të flas dhe të më dëgjosh, po deshe?

...Dhe këto shkelje të ligjit, kur bëhen në një nivel të tillë, vaj hallit se ç'ndodh me qytetarët, dhe ky duhet të jetë preokupim edhe imi, si deputet i opozitës, edhe yti, si deputet i maxhorancës, dhe yti, si kryetar i Komisionit të Ligjeve dhe të Kushtetutës, këtu në Kuvendin e Shqipërisë.

Pra, të mos bëjmë sikur nuk dimë asgjë. T'i flasim gjërat ashtu siç janë. Në qoftë se duhet pa mediat, të bëjmë një debat tonin të brendshëm se cili është funksioni i këtij komisioni dhe çfarë mund të bëjmë akoma më mirë për të mos lejuar që fenomene të tilla të ndodhin, për të mos e bërë thjesht objekt debati mediatik, por debati të brendshëm, si parlamentarë të përgjegjshëm, për të bërë atë që është më e mira dhe jo romuze për të hedhur dhe për të pritur, pa dyshim që këto lloj regatash do të sjellin.

Fatmir Xhafaj – Singerisht, nuk arrij dot ta kuptoj unë, por kuptoj vetëm një gjë, që kjo është për të bërë politikë për politikë. Ky është deformimi i rolit të Parlamentit. E kam shumë singerisht këtë, në qoftë se dëshironi të bëni deklaratë politike, nuk është vendi këtu. Prandaj është salla aty, dilet aty, bëhet deklaratë politike. Unë nuk dua të bëj deklarata politike këtu. A, po, unë mund të bëj gjykime politike për rendin e ditës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord, more, zotëri, por ka një rend dite. Kjo është ajo që po them unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord, unë nuk dua të bëj debat.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës, për marrëveshjen. Ju vini direkt nga fronti i punës, kështu që mund të na bëni një...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Leonard Miloti – Programi i ujësjellësve rural III, ka si qëllim kryesor furnizimin e popullsisë të zonave rurale me ujë të pijshëm 24 orë. Ky program mund të quhet vazhdim i dy programeve të mëparshme që kanë qenë gjatë periudhës 2008-2014, është i njëjti program, por ndryshimi është në zonën në të cilën mbulon. Ndryshimi i programit të parë me të dytin, ky program mbulon gjithë Shqipërinë, ndërsa ato kanë qenë të fokusuar në tre qarqet veriore të Shqipërisë: Dibër, Kukës dhe Shkodër.

Qëllimi tjetër kryesor është që të furnizohen me ujë të gjithë fshatrat që kanë një popullsi të lartë, të qëndrueshme. Sasia e fondeve që përfshihen në këtë program, është afërsisht 40 milionë euro, të ndara si më poshtë:

Shuma 24 milionë euro është huaja nga KfW-ja; 1,5 milion euro janë grant nga KfW-ja, të cilat do të përdoren për masat shoqëruese të projektit. Nga IPA 2013 kemi 9,8 milionë euro, dhe këto janë grant, që do të përdoren për financimin e projektit. Gjithashtu, para pak muajsh, është përfshirë edhe në relacion, është një shumë 670 mijë euro nga WBF, që do të përdoret për fizibilitetet teknike dhe sociale për këto ujësjellës. Pjesa tjetër është bashkëfinancimi 10 %, që është 4 milionë euro, që do të jetë nga njësitë e qeverisjes vendore ose nga qeveria qendrore.

Aktivitetet që përfshijnë këtë program janë seleksionimi i komunave dhe i fshatrave përkatëse që do të financohen më vonë. Kjo do të realizohet nga granti, nga fondi i grantit

WBF. Studimet e fizibiliteteve sociale dhe teknike do të bëhen përsëri nga granti. Qëllimi kryesor është minimumi 70 skema ujësjellësish të ndërtohen dhe ne presim më shumë, por ky është një vlerësim paraprak. Kryesisht, do të përqendrohemi tek ujësjellësit me gravitet, nuk përjashtohen dhe ujësjellësit me rritje mekanike me stacion pompash, por kjo është një kriter kryesor, pjesa e gravitetit prevalon mbi kërkesat që mund të kenë komunat për ngritje ujësjellësish me ngritje mekanike, kuptohet, pjesa teknike do zgjidhet me linjën e transmetimit me rezervuar deri në lidhjen me konsumatorin.

Një pjesë e këtij fondi, një pjesë e vogël, nuk është e përcaktuar, por mund të përdoret për emergjencat për ujërat e zeza, që mund të krijohen probleme pas ndërtimit të ujësjellësve.

Përsëri nga granti i KfW-së, që është 1,5 milion euro, është pjesa e masave shoqëruuese, është procesi i informimit të grupeve përfituese sensibilizimi i këtyre grupeve rreth higjienës dhe vlerës së ujit, lidhet edhe me shkarkimin e ujërave të zeza.

Një aktivitet tjetër është informimi i grupeve në lidhje me projektet e ujësjellësve respektivë për çdo...

Atëherë jashtë relacionit në lidhje me kriteret që duhen ditur ..

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Bashkim Fino – Pyetja ime konsiston në atë që unë dua të kuptoj kur të ngre dorën e të miratoj këtë grant, dua të kuptoj se përse e ngre dorën. Këtu na del se me 11,6 milionë euro janë ndërtuar rreth 30 skema ujësjellësish, kryesisht në qarqet Shkodër, Kukës dhe Dibër. Me grantin e ri, na thonë përfaqësuesit, minimalisht do të bëhen 70 skema ujësjellësish, pra që është një shumë shumë herë më e madhe, që është 39,3 milionë euro. Pyetja që kam unë është se a është bërë ndonjë lloj planifikimi konkret se sa do të harxhojmë nga këto para për të zgjidhur skemat e ujësjellësve? E para.

E dyta na u tha një fjali e përgjithshme që këto skema do të jenë në të gjithë Shqipërinë. Po se ku do të jenë këto 70 skema ujësjellësi, kjo do të vijë në parlament e shoqëruar sipas bashkive apo komunave përkatëse. Nuk mund të vihet këtu e të thuhet që ne do të bëjmë 70 skema ujësjellësish, na miratoni 40 milionë euro. Se ku do t'i bëjnë e dinë këta, ne vetëm do të ngremë dorën. Pra, unë do të desha të dija se ku janë shtrirë këto 70 skema? Mirë faza e parë dhe e dytë, por fazën e tretë duhet ta dimë se ku do të shtrihen këto 70 skema. Duhet të kemi një planifikim të saktë, nëse do të bëhen 69 apo 73. Këto janë para, janë fonde. Skemat e ujësjellësve

janë të matshme nga çdo lloj pikëpamjeje teknike dhe mund të nxjerrim me paratë që kemi sa ujësjellës do të bëjmë.

Pra, këto dy-tri pyetje mua më lënë të dyshoj që ky raport nuk është fort i zgjidhur drejt dhe saktë dhe do të doja sqarime të mëtejshme përpara se të votoj për to.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Fino!

Leonard Miloti – Lidhur me pyetjen e parë, që ka të bëjë me programin e parë dhe të dytë ku kanë qenë 11,6 milionë euro dhe 29 skema, ka një ndryshim në lidhje me programin që po financohet sot. Në programin e parë dhe të dytë kanë qenë totalisht skema me gravitet, pra me rënie të lirë, me kosto tjetër dhe nuk ka pasur asnjë komponent të kanalizimeve të ujërave të zeza. Kjo është arsyeja e diferencës ndërmjet programit të parë, të dytë dhe programit të tretë.

Në lidhje me pyetjen e zoti Fino, ky është një vlerësim paraprak i bërë nga donatori në muajin maj të vitit 2013, gjatë misionit të vlerësimit dhe nuk bëhet fjalë për skema konkrete dhe emra fshatrash. Këtu te masat shoqëruese dhe fizibilitetet sociale dhe teknike janë ata që do të përcaktojnë se ku do të ndërhyhet, në bazë të kriterëve që është rënë dakord me donatorin dhe që janë : skemat me gravitet, bashkëfinancimi në masën 10% nga komunat, kostoja duhet të jetë nën 350 euro për banor, kanë prioritet zonat e varfra, pra me ndihmë ekonomike dhe fshatrat që duhet të kenë një popullsi mbi 200 banorë për fshat. Këto janë kriteret kryesore mbi të cilat do të ndërtohen fizibilitetet teknike dhe atëherë ne do të jemi në gjendje të kemi listën e projekteve dhe të fshatrave që janë potencialisht të mundshëm për t'u financuar.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Peza.

Dashamir Peza – Së pari, më lejoni, zoti kryetar, që të jem në mbështetje të asaj që zoti Fino tha përpara, e gjej këtë relacion shumë konfuz dhe jo të qartë për ne.

E dyta, që më bën përshtypje është që përse për prezantuesit e projektit është kaq i parëndësishëm ky projekt që nuk kanë pasur mirësinë që të sjellin në komision qoftë edhe drejtorin e institucionit? Është kjo mungesë respekti për projektin, apo është mungesë respekti për komisionin?

Fatmir Xhafaj – Për kë do të përgjigjeni, për pyetjen për drejtorin? Po më mirë të mos përgjigjesh.

Leonard Miloti – U tha që nuk mund të vinte për arsye se është njoftuar dje pasdite.

Fatmir Xhafaj – Po do të them qëkur vini këtu, nuk është pazari i gjësë së gjallë këtu.

A ka pyetje të tjera? Nuk ka pyetje të tjera.

A ka diskutime? Po, zoti Fino.

Bashkim Fino - Nuk jam kundër në parim të projektit për ratifikimin e marrëveshjes. Kjo është një ndihmë shumë e madhe që merr qeveria jonë dhe organet e pushtetit vendor për rehabilitimin ujësjellësve. Më vjen mirë që në pjesën e programit të këtyre 30 skemave të ujësjellësve, sipas relacionit të paktën, kjo duhet verifikuar në terren, është dhënë ujë 24 orë, sepse, të paktën, shpëtojmë këto 30 skema të ujësjellësit që janë me 24 orë ujë. Do të duam që të financojmë dhe japim paratë për skema të tjera ujësjellësi, të cilat me siguri edhe ato do të japin ujë për 24 orë në ditë. Kështu të paktën e kuptoj unë, pavarësisht se nuk është shkruar në relacion. Ajo që na bën ne më sensibil është që çështja e ujësjellësve është çështje jetike, është një çështje të cilën kemi vite që deklarojmë se do ta bëjmë Shqipërinë me furnizim me ujë 24 orë, madje nga shumë forca politike, për shembull, është thënë se brenda 2-vjeçarit të parë, kështu ka thënë PD-ja dikur, do t'i japim ujë të gjithë zonës bregdetare, gjë që nuk mund të realizohej dot dhe nuk është realizuar ende tani që ka ikur nga pushteti. Shqipëria është vendi i dytë në Europë pas Norvegjisë për burimet ujore që ka dhe ne ende vuajmë për të bërë ujësjellës dhe për t'u dhënë 24 orë ujë qytetarëve shqiptarë. Por më vjen keq të them që mënyra e të shkruarit të këtij relacioni mua më duket shumë konfuze dhe jo shumë realiste, ndaj, përpara se të votohet në parlament, zoti kryetar, nga Fond i Zhvillimit Shqiptar dhe nga qeveria shqiptare të na vijë një relacion shtesë i konfirmuar tashmë, se cilat do të jenë 70 skemat e ujësjellësve në të gjithë Shqipërinë. Ku do të përfshihen ato? Cilat zona do të prekin? As për qëllime elektorale, politike apo personale të deputetëve të veçantë, absolutisht, por sipas skemës që ju keni të Fondit të Zhvillimit Shqiptar, nuk po ju ndërhyjmë fare për këtë çështje, por duam ta dimë, sipas atyre kritereve që ju thatë më përpara, të fshatrave që janë më në nevojë, që kanë 200 banorët etj., por do të doja vërtet dhe kjo duhet të zgjidhet patjetër, sepse ne duhet të dimë jo vetëm se ku shkojnë këto fonde, por duhet të dimë pastaj edhe t'i kontrollojmë, t'i shohim dhe të fillojmë t'i seleksionojmë pak nga pak sistemet e ujësjellësve që marrin 24 orë ujë.

Nga ana tjetër do të doja që ky financim që do të bëhet, i cili është i rëndësishëm, duhet të jetë edhe në funksion të ndarjes së re territoriale të hartës së Shqipërisë që ne tashmë e kemi kaluar edhe në funksion të zgjedhjeve të 21 qershorit, sepse ju patjetër duhet të bëni një koordinim të ri tashmë të këtyre fondeve edhe në funksion të këtyre bashkive të reja, që do të

thotë që, në qoftë se ne marrim një bashki, më mirë ta marrim ta përfundojmë një bashki sesa të bëjmë investime të copëzuara, siç keni thënë ju këtu, 70 skema ujësjellësish. Vërtet një zonë e caktuar mund ta ketë ujin 24 orë, por nuk mund të ketë zona tjetër më e madhe e një bashkie 24 orë. Ndërkohë, që unë mendoj se me këto fonde që ne kemi, më mirë marrim në konsideratë një, dy, tre apo katër bashki të mëdha, i financojmë ato, zgjidhim problemin e ujësjellësve përfundimisht dhe pastaj ecim më tej, se kjo do të jetë skema më e mirë.

Do të doja vërtet, zoti kryetar, që të jem edhe më i qartë, edhe më i kënaqur me veten time që informacioni që duhet të na vijë para votimit në parlament, duhet të përfshijë këto që thashë unë, mbase nuk po them ndonjë gjë të veçantë, por FZHZH-ja dhe qeveria shqiptare e kanë mundësinë të na i sjellin. Ne nuk ju imponojmë se ku do t'i jepni ato, se në çfarë zone a qyteti, por ama duhet ta kemi të detajuar një hartë të ujësjellësve në Shqipëri, ku fillojnë dhe ku mbarojnë përfundimisht ujësjellësit në Shqipëri për 24 orë në të gjithë Shqipërinë. Kjo është më se e domosdoshme dhe ne duhet ta kemi tashmë.

Ne sot nuk e kemi një gjë të tillë, sa herë që vijnë këtu projekte të tilla, që janë të rëndësishme, i votojmë, por ne nuk dimë në territorin e Shqipërisë sesi është situata, dhe si do të shkojë situata në këtë 61 bashki që do të dalin nesër nga zgjedhjet e 21 qershorit. Prandaj mendoj që një informacion më i plotë për të qenë të qetë për të votuar këtë grant, do të ishte shumë i rëndësishëm edhe në votimin që do të bëhet në parlament.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera?

Fjalën e ka zonja Hysi!

Më pas zoti Vasili.

(Diskutime pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Ju kërkoj ndjesë që i kthehem kësaj, por, duke parë listën e aktiviteteve që do të financohen nga ky projekt, që është në një shumë të konsiderueshme, rezulton që pjesa më e madhe është fushatë sensibilizuese, sepse po të shikoni është informimi i grupeve përfituese për tarifat e reja, sensibilizimi i grupeve përfituese, informimi i grupeve përfituese për projektet e ujësjellësit, trajnime, prezantimi i tarifave, masa shoqëruese për sensibilizim dhe informim. Në fakt nuk më rezulton që këtu ka riparime të rrjeteve, sepse edhe te pika 3, ku thuhet: “rehabilitimi

ose rindërtimi të paktën e 70 skemave të ujësjellësve”, kjo është në raste urgjente dhe nuk dihet ku janë.

(Diskutime pa mikrofon)

Dhe të harxhosh 9 milionë euro për të bërë këtë lloj aktiviteti...

Fatmir Xhafaj – Po nuk është për atë. Lexoje nga fillimi deri në fund.

Vasilika Hysi – Aktivitetet që do të financohen janë pjesa më e madhe sensibilizim dhe informim.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Vasili!

Petrit Vasili – Unë mendoj që ne mund ta plotësojmë këtë diskutim në parimvetëm me disa gjëra e shifra më konkrete për çështjen, sepse besoj që një gjë është e zakonshme dhe nuk ma do mendja që të ketë dalë edhe kjo procedurë jashtë kësaj. Nuk besoj, mbase këtë duhet ta dinë edhe zotërinjtë që vijnë këtu, që fondi akordohet pa u planifikuar më parë aktiviteti, sepse në praktikën e negocimit nuk merren në fillim paratë dhe më pas gjërat përcaktohen. Një nga kushtet kryesore është, siç funksionojnë të gjitha, nuk ka rëndësi kredi apo grant, që në fillim janë vendosur se cilat janë raportet e pjesës rehabilituese konkrete, cila është pjesa e formimit të opinionit apo rritjet e kapaciteteve menaxheriale. Mendoj që ne në parim i kemi të gjitha arsyet për të qenë mbështetës të kësaj nisme, nuk kemi ndonjë arsye, të them, parimore për të qenë kundër.

Elementet e tjera të detajuara, të cilat sigurisht janë negociuar, sepse dihet që marrëveshja derisa ka ardhur në Këshillin e Ministrave është negociuar edhe në raportet e saj, pasi dihet që ka edhe disa raporte, se cila është pjesa ku ndërhyhet në pjesën infrastrukturore dhe cilat janë pjesët e tjera që plotësojnë një projekt, ku dihen edhe pjesët e sensibilizimit, edhe njohja e tarifave. Edhe këto janë pjesë përbërëse të një programi të caktuar, të një mënyre të re të menaxhimit të ujësjellësve në rastin konkret.

Unë them që ne duhet të ndajmë sot një gjë në parim, jemi për ta miratuar këtë mbështetje financiare dhe sigurisht, materialet shtesë ekzistojnë, sepse nuk ka mundësi që të vijmë këtu pa pasur të detajuar se ku shkojnë, cilat janë raportet që na bëjnë që të kuptojmë sa është njëra me tjetrën. Të gjithë jemi të qartë dhe nuk mendoj që ka njeri këtu të mendoj që në 9 milionë euro që janë këtu, 8 milionë e ca të jenë aktivitete sensibilizuese, 1 milion qenkan rehabilituese. Kjo nuk

mund të ndodhë, nuk ka mundësi të ndodhë. Qeveria është po aq e përgjegjshme sa edhe ne në këtë çështje.

Për sa i përket materialit, sigurisht që janë të detyruar, mbase duhet të na kishte ardhur me kohë, siç ka qenë zakon, ku kishte edhe ndarje sipas çështjeve themelore të buxhetit, do të vinte këtu dhe do ta kishim edhe ne, dhe shumë nga këto pyetje që ne bëjmë do të ishin të shteruara në atë material.

Unë them që në parim mbështetja duhet miratuar. Është një mbështetje për një sektor jetik, siç është sektori i ujësjellësve, që ka trashëguar plot histori edhe të mira, por edhe të shëmtuara, edhe ndërhyrje të bëra siç duhet, edhe ndërhyrje të bëra sa për aparencë. Unë jam i bindur që përgjegjshmëria që ekzekutivi ka për pjesën e historive të shëmtuara, ku veprat ujitëse bëheshin pa kualitet apo që fiktivisht duheshin për t'u inauguruar në një moment elektorale dhe më tutje të mos funksiononin, besoj që është e papajtueshme me maxhorancën tonë, mendoj që është momenti për t'u shprehur në parim pozitivisht për këtë çështje dhe të gjitha elementet e tjera sqaruese, detaje të tjera të rëndësishme për t'u njohur nga të gjithë kolegët, besoj se janë të mundshme për t'u sjellë.

Fatmir Xhafaj – E mbyllim këtu diskutimin. Para se të votojmë, fjalën e ka relatori.

Vexhi Muxhmataj – Faleminderit, zoti kryetar!

Të dyja marrëveshjet kanë të bëjnë me fazën e tretë të këtij projekti. Natyrisht, qëllimi i marrëveshjeve është rehabilitimi i sistemit të ujit të pijshëm për zonat rurale me qëllim përmirësimin e këtij shërbimi për banorët e këtyre zonave. Unë nuk do të zgjatem, sepse përfaqësuesit e institucionit përshkruan hollësisht disa nga shifrat e grantit, ajo që desha të them është se jam dakord me vërejtjen e deputetit Fino se të dyja marrëveshjet duhet të vijnë me një relacion shtesë në Kuvend, që ne deputetët të shohim se ku janë planifikuar fondet e këtij granti për përmirësimin e sistemit të furnizimit me ujë të pishëm.

Të dyja marrëveshjet nga shqyrtimi dhe studimi i tyre në aspektin ligjor dhe procedural janë të mbështetura në kërkesat e nenit 121 e vijues të Kushtetutës dhe në rregulloren e Kuvendit. Për këtë arsye, unë i propozoj këtij komisioni t'i miratojmë këto dy marrëveshje dhe t'i kalojmë në seancë plenare për shqyrtim.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit! Vërejtjet që bënë këshilltarët për t'u paraqitur në seancë, të shkruhen jo vetëm në relacion, por t'i bëhet kërkesë me shkrim edhe seksionit

përgjegjës që t'i sjellin, në mënyrë që kjo të ndihmojë diskutimin në seancë plenare dhe votimin e deputetëve. Pavarësisht se zotërinjtë e FSHZH-së janë të pranishëm, ne do t'jua çojmë edhe zyrtarisht sot kërkesën.

Kush është dakord me projektligjin e parë? Dakord.

Neni 1? Dakord.

Neni 2? Dakord.

Kush është dakord në tërësi? Dakord.

Vazhdojmë me projektligjin tjetër sepse relatori përmbledhi gjykimin dhe nuk ka ndonjë gjë më shumë për të shtuar. Në lidhje me projektligjin tjetër a ka ndonjë gjë për të shtuar?

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar! Me të drejtë relatori i përfshiu të dy projektligjet se këto kanë lidhje me njëri-tjetrin, por nga një studim që i kam bërë relacionit të dy projektligjeve, ato janë të njëjta fjalë për fjalë dhe nuk japin dallimin se çfarë ofron njëri ligj dhe se çfarë ofron tjetri.

Fatmir Xhafaj – Janë për të njëjtin projektligj, por janë marrë në kohë të ndryshme, dhe janë bërë dy marrëveshje. A është kjo logjika, apo jo?

(Diskutime pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Po, e kuptova, zoti kryetar! Projekti i miratuar me vendimin numër 113 të qeverisë ka të bëjë me ndërtimin e sistemeve të ujërave rurale dhe nëse është e zbatueshme masa plotësuese për ujërat e zeza.

Projektvendimi numër 114 miraton një tjetër projektligj, që ka të bëjë me masat shoqëruese dhe të këto masa përmenden trajnime, kualifikime etj, por po të shikosh përmbajtjen relacioni në të dyja projektligjet flet për trajnime dhe kualifikime, pra nuk është e qartë.

Fatmir Xhafaj – Nuk flet vetëm për trajnime, por edhe për studime fizibiliteti, reabilitim ose ndërtim linjash transmissiioni rezervuar në rrjetet e shpërndarjes. A e lexon apo jo?

Vasilika Hysi – Veçse thotë nëse është e zbatueshme për masa plotësuese për ujërat e zeza në rastet emergjente, po të lexoni relacionin sepse do të ishte e rekomandueshme, që secili projektligj të kishte relacionin e vetë.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Vërejtjen e zonjës Hysi, përfshijeni në relacion në seancën plenare.

Kush është dakord në parim me këtë projektligj? Dakord.

Neni 1? Dakord.

Neni 2? Dakord.

Në tërësi? Dakord.

Faleminderit!

E mbyllim këtu këtë marrëveshje me vërejtjet e bëra nga kolegët që kanë të bëjnë me përfaqësimin jo të përshtatshëm të institucioneve shtetërore në rastin e këtyre dy marrëveshjeve, për sa i përket nivelit të përfaqësimit, por edhe mënyrës së paraqitjes. E dyta, me vërejtjet që u bënë konkretisht nga deputetët Fino dhe Hysi, që kanë të bëjnë me përmbajtjen e projektligjit dhe dokumenteve shtesë që duhet ta shoqërojnë atë për debatin dhe votimin në seancë plenare.

Faleminderit zotërinj, që ishit në këtë seancë!

Sekretar

Armando Subashi

Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve

Euzheni Pengili



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 10.03.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (nenet 135- 160)

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Blendi Klosi, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Petrit Vasili, Silva Caka, Eduart Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka.

Mungojnë: Tom Doshi

Të ftuar:

Eljona Bylykbashi, specialiste në Ministrinë e Drejtësisë.

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj - Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës që është “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili është punuar nga këshilltarët së bashku me Ministrinë e Drejtësisë.

Vazhdojmë me seksionin 4, neni 135, “Kompensimi”? Dakord?

Eljona Bylykbashi – Dakord.

Fatmir Xhafaj - Neni 136, “Rimbursimi”? Dakord?

Eljona Bylykbashi – Dakord.

Fatmir Xhafaj - Neni 137? Dakord?

Eljona Bylykbashi - Dakord.

Fatmir Xhafaj – Pas kreut të katërt, shtohet seksioni i parë, “kontrata administrative” dhe fillon me ndryshimet që janë bërë në nenin përkatës, siç janë të formalizuara në dokumentin që keni përpara në shqyrtim.

Vazhdojmë me nenin tjetër “kontrata administrative” që zëvendëson “aktin administrativë”, që ndryshon që në titull “kontrata administrative” zëvendësuese me tekstin e paraqitur në dokument. Dakord?

Eljona Bylykbashi – Dakord.

Fatmir Xhafaj – “Kontrata administrative ndërmjet organeve publike”, siç është. Dakord?

Eljona Bylykbashi – Dakord.

Fatmir Xhafaj – “Pavlefshmëria e kontratës administrative” me ndryshimin e bërë. Dakord?

Eljona Bylykbashi – Dakord.

Fatmir Xhafaj – “Ndryshimi, prishja apo tërheqja nga kontrata administrative”. Neni 141, pika 2, e ndryshuar dhe e ndarë në pikën 2 dhe 3, si vijon të paraqitura në dokumentin që keni përpara. Dakord?

Eljona Bylykbashi – Dakord.

Fatmir Xhafaj – “Zbatësimi i dispozitave të tjera ligjore”. Neni 142 i hiqet pika 1, sepse parimet e këtij kodi, dispozitat e tjera të tij taksative e përfshijnë edhe institutin e kontratës administrative. Dakord?

Eljona Bylykbashi – Dakord.

Fatmir Xhafaj – “Zgjidhja e mosmarrëveshjeve” mbetet siç është. Dakord?

Eljona Bylykbashi – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Kreu 5, “Veprime të tjera administrative” hiqet, sepse është njësh me kreun e mësipërm, dhe shtohet seksioni 2 “Forma të tjera të veprimeve administrative”. Dakord?

Eljona Bylykbashi – Dakord.

Fatmir Xhafaj – “Veprime të tjera administrative në regjimin e së drejtës administrative”, neni 144 ndryshohet me këtë emërtim si vijon në tekstin bashkëngjitur. Dakord?

Eljona Bylykbashi – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 83 si rrjedhojë e lëvizjeve të mëparshme të dispozitave të riformatimit kryetërthorë të shërbimeve publike vendoset këtu. Dakord?

Eljona Bylykbashi – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Pjesa 6, “ Mjetet e ankimit administrativ”, titulli i kreut të parë, “Dispozitat e përgjithshme për mjetet e ankimit administrativ” ndryshohet si vijon në “dispozita të përgjithshme”. Dakord?

Eljona Bylykbashi – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 145 ndahet në tri nene, siç janë paraqitur në dokument “Legjitimimi, mjetet e ankimit administrativ dhe kushti për shterimin e ankimit administrativ”. Dakord?

Eljona Bylykbashi – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Kreu i dytë, “Ankimi administrativ, kushtet për paraqitjen dhe efektet”, sugjerohet të titullohet “ankimi administrativ”, pas kreut të dytë shtohet seksioni i parë “Kushtet dhe efektet e ankimeve administrative, kërkesat formale të ankimit administrativ”. Dakord?

Eljona Bylykbashi – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 146 titullohet “Objekti dhe organi, të cilit i drejtohet ankimi administrativ” dhe ka ndryshimet e bëra nga ekspertët dhe që është paraqitur nga ekspertët. Dakord?

Eljona Bylykbashi – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 147 sugjerohet të ndryshojë si vijon sipas propozimit të bërë nga ekspertët. Dakord?

Eljona Bylykbashi – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 148, “Organit të cilit i drejtohet ankimi sugjerohet nga ekspertët të hiqet, sepse është reflektuar në dispozitat e mësipërme që kemi kaluar gjatë shqyrtimit të tyre në këtë komision. Dakord?

Eljona Bylykbashi - Dakord.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

“Afatet e ankimit administrativ” riformulohet sipas tekstit të bashkëngjitur. Dakord?

Eljona Bylykbashi - Dakord.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Neni 150, “Efektet e ankimit administrativ” ndryshohet sipas tekstit të propozuar nga ekspertët. Dakord?

Eljona Bylykbashi - Dakord.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Kreu i tretë, “Procedura e shqyrtimit të ankimit ndaj aktit dhe refuzimit administrativ” bëhet seksioni i dytë i titulluar “Procedura e shqyrtimit të aktit administrativ”. Dakord?

Eljona Bylykbashi - Dakord.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Neni 151 dhe neni 152 shkrihen në të njëjtën dispozitë, propozojnë ekspertët. Dakord?

Eljona Bylykbashi - Dakord.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Neni 152, “Procedura e shqyrtimit të ankimit nga organi publik epror” është përfshirë në një nen të mëparshëm dhe hiqet, meqenëse është bashkuar në dispozitën që sapo kaluam. Dakord?

Eljona Bylykbashi - Dakord.

Fatmir Xhafaj - Neni 153 ndahet në dy nene dhe ndryshohet sipas tekstit në të cilin parashikohet, sipas propozimit të ekspertëve, që neni 153 “Mospranimi i ankimit” dhe neni 154 “Vendimi i organit publik që shqyrton ankimin” me formulimet e paraqitura në tekstin që keni përpara. Dakord?

Eljona Bylykbashi - Dakord.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

“Procedura e shqyrtimit të ankimit ndaj mosveprimeve administrative dhe përmbajtja e vendimit të ankimit” është kreu tjetër. Neni 154 sugjerohet nga ekspertët të hiqet. Dakord?

Eljona Bylykbashi - Dakord.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Neni 155, gjithashtu. Dakord?

Eljona Bylykbashi - Dakord.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Kreu i pestë numërohet kreu i tretë dhe sugjerohet të ndryshohet “Kundërshtimi administrativ”.

Neni 156 sugjerohet të hiqet. Dakord?

Eljona Bylykbashi - Dakord.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Neni 157 ndryshohet si vijon me tekstin e paraqitur nga ekspertët në dokumentin që keni në tryezë. Dakord?

Eljona Bylykbashi - Dakord.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Neni 158 sugjerohet nga ekspertët të hiqet, sepse është shkrirë me nenin 157, dakord?

Eljona Bylykbashi - Dakord.

Fatmir Xhafaj - Dakord. Neni 159 ndryshohet “Forma e kundërshtimit administrativ, përmbajtja e kundërshtimit administrativ dhe afati”, sipas formulimit që keni në tabelë. Dakord?

Eljona Bylykbashi - Dakord.

Fatmir Xhafaj - Neni 160 ndryshohet si vijon “Shqyrtimi i kundërshtimit administrativ” me tekstin e paraqitur nga ekspertët. Dakord?

Eljona Bylykbashi - Dakord.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Kreu i katërt është një dispozitë “Rihapja e procedurës”, janë disa nene që janë parashikuar edhe me propozim të SIGMA-s, në mos gaboj.

Eljona Bylykbashi - Po.

Fatmir Xhafaj - Kështu është, ekspertët e SIGMA-s apo jo?

Eljona Bylykbashi - Po, ekspertët e SIGMA-s.

Fatmir Xhafaj - Po, është sugjerimi i tyre për ta bërë këtë. Janë shtuar edhe nene të reja. Neni i ri, po e numërojmë për lehtësi leximi të tekstit në tavolinë, por që do të ndryshojnë me tekstin integral që do të zbardhet në fund të kësaj procedure. Pra, neni i ri 160 “a”, “Rihapja e procedurës”, dakord?

Eljona Bylykbashi - Ministria e Drejtësisë është dakord me variantin e miratuar në Këshillin e Ministrave, por mbetet e hapur për diskutim.

Fatmir Xhafaj - Dakord. Atëherë, mbani shënim se kjo do të jetë pjesë e tryezës, të ngelet me rezervën që para miratimit përfundimtar kjo do të jetë një çështje e diskutueshme. Neni i ri, 160 “b” gjithashtu, dakord? Neni i ri 160 “c”, dakord?

Së pari, për pjesën e mbetur të neneve duhet të bëhet përpjekje për t’u mbyllur brenda kësaj jave në mënyrë që të mbyllem tekstin tërësor të ligjit dhe më pas të diskutohet për përgatitjen e një teksti integral nga ekspertët e ministrisë, të Kuvendit dhe ekspertët e thirrur në mbështetje të ekspertizës sonë së bashku me SIGMA-n.

Së dyti, për të bërë një tryezë diskutimi me ekspertët e SIGMA-s, ekspertët më të mirë që kemi në brenda vendit në fushën e të Drejtës Administrative dhe Procedurave Administrative, gjithashtu, me ekspertët ndërkombëtarë për të definuar përfundimisht ato 10-12 nene që kanë shumë diskutim. Besoj se duhet të përgatitemi që nga ky moment, këshilltarët të njoftojnë SIGMA-n për datën e përafërt të kësaj tryeze, që ata të kenë kohën e nevojshme për t’u paraqitur,

për të qenë pjesëtarë në tryezë. Paraprakisht t'u vendoset në dispozicion se cilat janë dispozitat e diskutueshme.

Faleminderit, zonja Bylykbashi! Faleminderit, përfaqësuesve të ministrisë, këshilltarëve tanë dhe ekspertëve të jashtëm të fakultetit dhe të fushës së të Drejtës Administrative, që kanë punuar me shumë seriozitet dhe vazhdojnë të jenë shumë skrupuloz, me të drejtë, në hartimin e dispozitave të këtij ligji të rëndësishëm!

E mbyllim këtu. Mbledhja tjetër do të jetë nesër në orën 10:00 sipas rendit të ditës.

MBLEDHJA MBYLLET